REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit të saj, realizimit të shërbimeve cilësore të radios dhe televizionit për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë edhe pakicat kombëtare;

Duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, ofrimin e një game të gjerë projektesh në interes të grupeve të ndryshme sociale, rritjen e audiencës dhe shtrirjen sa më të madhe në vend;

Duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm dhe të balancuar të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare, duke bërë të mundur rritjen e besimit të publikut;

Vlerëson se Radiotelevizioni Shqiptar gjatë vitit 2025:

Ka pasur transmetim në strukturën programore të RTSH-së me 15 kanale televizive dhe 11 radiofonike duke mbuluar mbi 95% të territorit me programacion të shumëllojshëm, me qëllim plotësimin e misionit informues, edukues dhe argëtues.

Ka qenë i angazhuar për ndërmarrjen e procesit paraprak të hartimit të një plani strategjik në bashkëpunim me *European Broadcasting Union* (EBU), me fokus ristrukturimin organizativ, transformimin digjital dhe përmirësimin e përmbajtjes programore.

Ka rritur nivelin e transparencës institucionale dhe miratimit të akteve administrative, të cilat synojnë forcimin e standardeve të qeverisjes së brendshme dhe funksionimit institucional.

Ka marrë masa për stabilizimin e situatës financiare duke sjellë ulje të pjesshme të detyrimeve të prapambetura.

Ka forcuar diversitetin kulturor përmes transmetimit të përmbajtjeve programore, duke garantuar përfshirje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe komunitetet.

Kuvendi rekomandon që Radiotelevizioni Shqiptar për vitin 2026 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të miratojë brenda 3-mujorit të tretë të këtij viti planin strategjik të shoqëruar me objektiva të matshëm, indikatorë performance dhe mekanizma raportimi periodik 6-mujor për Kuvendin.
2. Të racionalizohet portofoli i kanaleve televizive dhe radiofonike drejt një numri më të vogël me identitet të qartë editorial, duke shmangur mbivendosjet dhe duke përafruar numrin e kanaleve me kapacitete reale prodhuese dhe financiare.
3. Të paraqesë në Kuvend një plan operacional dhe financiar të dedikuar për përfundimin e digjitalizimit të arkivit me kërkesa eksplicite buxhetore për të shmangur degradimin e pakthyeshëm të fondit të arkivit kombëtar brenda muajit tetor të këtij viti.
4. Në bashkëpunim me Kuvendin, të ridimensionojë kanalin që transmeton programacion për Kuvendin në funksion të informimit, konsultimit publik dhe edukimit qytetar për procesin legjislativ.
5. Të forcohet pavarësia institucionale dhe editoriale dhe të ndërmerren masa konkrete për garantimin e pluralizmit editorial ,në përputhje me standardet evropiane.
6. Të rrisë transparencën përmes publikimit të vendimeve dhe dokumentacionit shoqërues të organeve drejtuese, si dhe të aseteve që RTSH-ja administron.
7. Të trajtohet si prioritet i menjëhershëm modernizimi i infrastrukturës teknike duke investuar për zëvendësimin e pajisjeve të amortizuara dhe zgjerimin e kapaciteteve prodhuese.
8. Të angazhohet në hartimin e një plani financiar, me qëllim riekuilibrimin e strukturës së shpenzimeve dhe sigurimin e burimeve për investimet strategjike dhe t'ia përcjellë Kuvendit brenda muajit tetor të këtij viti.
9. Të investojë në kualifikimin profesional të gazetarëve dhe stafit teknik në bashkëpunim me EBU-në dhe partnerët ndërkombëtarë.
10. Të rrisë investimet në prodhimet origjinale shqiptare në fushën e informacionit, dokumentarit, kulturës, historisë, edukimit dhe programeve për fëmijë dhe të rinj.

11. Të krijojë një sistem të aksesueshëm për studiuesit, institucionet arsimore dhe publikun për konsultimin e arkivit të digjitalizuar, duke respektuar të drejtat e autorit dhe ligjet në fuqi.

12. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të këtij viti.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi